



UNIVERSITETI PUBLIK "KADRI ZEKA" UNIVERSITY

Zija Shemsiu pn., 60000. Gjiilan. Republika e Kosovës

www.uni-gjilan.net tel: 0280390112

Ref. Nr. 01 / 742 Dt. 18 / 04 2022

Bazuar në dispozitat e nenit 8, paragrafi 3, nën paragrafi 3.5 dhe nenit 13, paragrafi 2 nën paragrafi 2.3 të Ligjit Nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, nenit 48 paragrafi 1, nën paragrafi 1.9, dhe nenit 233 paragrafi 1 të Statutit të Universitetit, Senati i Universitetit në mbledhjen XXXII, të mbajtur më 31.03.2022 dhe në mbledhjen XXXIII, mbajtur më 28.04.2022, miratoi këtë:

RREGULLORE

PËR PROCEDURAT PËRZGJEDHËSE LIDHUR ME EMËRIMIN, RIEMËRIMIN DHE AVANCIMIN E PERSONELIT AKADEMIK NË UNIVERSITETIN PUBLIK "KADRI ZEKA" GJILAN

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

1. Kjo rregullore ka për qëllim rregullimin dhe përcaktimin:
2. Kushteve, kriterëve dhe procedurave përzgjedhëse lidhur me procesin për emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në marrëdhënie të rregullt pune në UKZ, bazuar në Ligjin për Arsimin e Lartë, Statutin e Universitetit dhe dispozitat e kësaj rregulloreje.
3. Çështjet që nuk janë rregulluar shprehimisht në Statutin e UKZ-së lidhur me procedurat dhe kriteret për avancim dhe emërim të personelit akademik.

Neni 2

1. Profesorët e rregullt, profesorët e asociuar dhe profesorët asistentë, asistentët universitarë, lektorët dhe korepetitorët duhet të jenë në gjendje të dëshmojnë një sfond të suksesshëm të mësimdhënies, të hulumtimit dhe të praktikës profesionale apo artistike.

2. Ndalesat për shpallje të konkursit:
 - 2.1. Vetëm personeli i brendshëm akademik që ka marrëdhënie të rregullt të punës në UKZ mund t'i nënshtrohet konkursit për rizgjedhje apo avancim.
 - 2.2. Personeli akademik i brendshëm që ka një funksion tjetër jashtë UKZ-së, të cilit iu është pezulluar kontrata e rregullt e punës dhe që kompensohet vetëm për orët e realizuara në UKZ, nuk ka të drejtë të rizgjidhet dhe as avancohet gjatë periudhës së ushtrimit të funksionit jashtë UKZ-së.
 - 2.3. Personeli akademik që mban funksione publike dhe që ka pezulluar marrëdhënien e punës në UKZ, gjatë kësaj periudhe të pezullimit nuk mund t'i nënshtrohet konkursit për rizgjedhje dhe avancim.

Neni 3

1. Universiteti siguron dhe mbështet barazinë gjinore.
2. Në rastin kur kandidatët e gjinisë mashkullore dhe asaj femërore i kanë kualifikimet e njëjta, përparësi do t'i jepet kandidates femër.

Neni 4

1. Në stafin akademik të Universitetit do të punësohen apo angazhohen personat për:
 - 1.1 Mësimdhënie akademike;
 - 1.2 Kërkime shkencore;
 - 1.3 Krijimtari artistike.
2. Personeli akademik përbëhet nga:
 - 2.1 Profesorët e rregullt (Prof. Dr.);
 - 2.2 Profesorët e asociuar (Prof. Asoc. Dr.);
 - 2.3 Profesorët asistentë (Prof. Ass. Dr.)
 - 2.4 Asistentët universitarë (Ass.);
 - 2.5 Lektorët dhe korepetitorët.

Neni 5

KUSHTET PËR PRANIMIN DHE ZGJEDHJEN E STAFIT AKADEMIK PËR FITIMIN E TITULLIT AKADEMIK PROFESOR I RREGULLT (PROF. DR.)

1. Në bazë të nenit 170 të Statutit të Universitetit, personeli akademik, i cili ka titullin akademik "Profesor i asociuar", aplikon për fitimin e titullit akademik "Profesor Doktor", të paktën 4 (katër) vjet pas fitimit të titullit akademik "Profesor i asociuar".
2. Për titullin e profesorit të rregullt kandidati duhet të ketë:

- 2.1 Gradën e doktorit të shkencës dhe thirrjen e profesorit të asociuar;
- 2.2 Udhëhequr me sukses së paku tri (3) tema master dhe së pakut një (1) temë të doktoratës (mentorimi i doktoratave vlen 3 vjet pasi të themelohen studimet e doktoratës në UKZ);
- 2.3 Një numër të monografive (së paku dy (2) monografi; doktorata e publikuar njihet si një monografi; kur është në interes të kandidatit, mund të bëhet ekuivalentimi i një monografie me dy punime shkencore të publikuara në WoS /SCOPUS.
- 2.4 Tekste mësimore (së paku një (1) tekst mësimor);
- 2.5 Publikime në revista ndërkombëtare shkencore ose artistike me më së paku 5 punime kryesore të publikuara në revista shkencore ose artistike ndërkombëtare, në pajtim me aktet juridike në fuqi, nga të cilat dy (2) duhet të jenë të publikuara pas fitimit të thirrjes së fundit akademike;
- 2.6 Pjesëmarrje aktive në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare, me më së paku 5 pjesëmarrje aktive (të dëshmuara në njërin formë: me proceedings book, botim të abstrakteve apo agjendën e konferencës si referues), nga të cilat dy (2) duhet të jenë pas thirrjes së fundit akademike;
- 2.7 Përvojë afatgjatë në projekte të kërkimeve themelore dhe të aplikueshme;
- 2.8 Aftësi të lartë arsimore dhe pedagogjike përmes praktikës;
- 2.9 Aftësi për udhëheqje akademike;
- 2.10 Krijime ose punime artistike, të ketë pasur prezantime publike kombëtare dhe ndërkombëtare, kur është rasti i profesorëve të fushës së arteve.
3. Raporti i Komisionit Vlerësues për angazhimin dhe pjesëmarrjen e kandidatit në veprimtaritë e parashikuara në paragrafin 2 hartohet në mënyrë të detajuar nga Komisioni vlerësues.
4. Emërimi për titullin *Profesor i Rregullt*, si dhe kohëzgjatja e punësimit bëhen për kohë të pacaktuar.

Neni 6

KUSHTET PËR FITIMIN E TITULLIT AKADEMIK PROFESOR I ASOCIUAR (PROF. ASOC. DR.)

1. Në bazë të nenit 171 të Statutit të Universitetit, aplikimi për fitimin e titullit akademik “Profesor i asociuar”, bëhet të paktën, 4 (katër) vjet pas fitimit të titullit akademik “Profesor asistent”;
2. Për titullin e profesorit të asociuar kandidati duhet të ketë:
 - 2.1 Gradën e doktorit të shkencës dhe thirrjen e profesorit asistent;
 - 2.2 Udhëhequr me sukses së paku një (1) temë master;
 - 2.3 Një numër të monografive (doktorata e publikuar njihet si monografi);

- 2.4 Publikime në revista ndërkombëtare shkencore ose artistike me më së paku tri (3) punime kryesore të publikuara në revista shkencore ose artistike ndërkombëtare, në pajtim me aktet juridike në fuqi, nga të cilat dy (2) duhet të jenë të publikuara pas fitimit të thirrjes së fundit akademike;
- 2.5 Pjesëmarrje aktive në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare, me më së paku tri (3) pjesëmarrje aktive (të dëshmuara në një të njënjë formë: me proceedings book, botim të abstrakteve apo agjendën e konferencës si referues), nga të cilat dy (2) duhet të jenë pas thirrjes së fundit akademike;
- 2.6 Të tregojë aftësi për mësimdhënie;
- 2.7 Të dëshmojë punë, dije dhe mjeshtri në lëndën e fushës përkatëse;
3. Krijime ose punime artistike, të ketë pasur prezantime publike kombëtare dhe ndërkombëtare, kur është rasti i profesorëve të fushës së arteve.
4. Emërimi për titullin “Profesor i asociuar”, si dhe kohëzgjatja e punësimit është për 4 vjet.

Neni 7

KUSHTET PËR FITIMIN E TITULLIT AKADEMIK PROFESOR ASISTENT (PROF. ASS. DR.)

1. Në bazë të nenit 172 të Statutit të Universitetit, për titullin e profesorit asistent kandidati duhet të ketë:
 - 1.1. Gradën e doktorit të shkencës (në lëndët e arteve figurative dhe muzikore, grada ekuivalente me të – master i arteve);
 - 1.2. Një numër të monografive (disertacioni i doktoratës njihet si monografi);
 - 1.3. Publikime në revista ndërkombëtare shkencore ose artistike me më së paku një (1) punim kryesor nga fusha përkatëse të publikuar në revista shkencore ose artistike ndërkombëtare, në pajtim me aktet juridike në fuqi, po jo më i vjetër se tri (3) vjet nga dita e kandidimit për thirrjen profesor asistent;
 - 1.4. Pjesëmarrje aktive në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare, me më së paku një pjesëmarrje aktive (të dëshmuara në një të njënjë formë: me proceedings book, botim të abstrakteve apo agjendën e konferencës si referues);
 - 1.5. Të tregojë aftësi për mësimdhënie, e cila dëshmohet me së paku dy (2) vjet përvojë pune në mësimdhënie të arsimit të lartë;
 - 1.6. Të dëshmojë punë, dije dhe mjeshtri në lëndën e fushës përkatëse;
 - 1.7. Të ketë krijuar punime të vërteta artistike ose të ketë pasur prezantime publike, kur është rasti për fushën e arteve;
 - 1.8. Kandidatët që vijnë me një PhD nga Universitetet e renditura në 500 vendet e para në World University Ranking, (<https://www.timeshighereducation.com/world-university-rankings>) kanë përparësi në procesin e pranimit;

2. Emërimi për titullin “Profesor asistent”, si dhe kohëzgjatja e punësimit është për 4 vjet.

Neni 8

KUSHTET PËR FITIMIN E TITULLIT ASISTENT UNIVERSITAR DHE PRANIMI NË PUNË (ass.)

1. Në bazë të nenit 173 të Statutit të Universitetit, për titullin e asistentit kandidati duhet t'i plotësojë këto kushte:
 - 1.1 Të ketë të përfunduar me sukses studimet universitare dhe master në drejtimin përkatës;
 - 1.2 Të jetë jo më i vjetër se deri në datën kur i mbushë 30 vjet për emërimin e parë; për Fakultetin e Mjekësisë deri në datën kur i mbushë 35 vjet;
 - 1.3 Të jetë i regjistruar në studimet e doktoratës në universitet me rastin e rizgjedhjes;
 - 1.4 Të ketë notën mesatare, në secilin nivel, jo më pak se 8 (tetë);
2. Të gjitha emërimet, si dhe kohëzgjatja e punësimit janë për 3 (tre) vjet.
3. Asistentët mbajnë orët e ushtrimeve në studimet baçelor dhe master.
4. Përrjashtimisht, asistenti që është rizgjedhur dhe është doktorant (PhD. cand.), në mungesë të profesorit për lëndën mund të autorizohet për mbajtjen e ligjëratave të kufizuara në studimet baçelor me autorizimin e Këshillit të njësisë akademike dhe nën mbikëqyrjen e një mësimehdhënësi nga departamenti.

Neni 9

KUSHTET PËR FITIMIN E TITULLIT LEKTOR DHE KOREPETITOR

1. Në bazë të nenit 174 të Statutit të Universitetit, për titullin e lektorit të gjuhëve të huaja, kandidati duhet t'i plotësojë këto kushte:
 - 1.1. Të ketë të përfunduar me sukses studimet master në gjuhën e zgjedhur;
 - 1.2. Të ketë aftësi të shkëlqyeshme të gjuhës së zgjedhur;
 - 1.3. Të ketë notën mesatare të studimeve bachelor dhe master jo më pak se 8, në secilën prej këtyre studimeve.
2. Lektorët në fakultetet e tjera, pos në fakultetin amë, i kanë të gjitha të drejtat dhe obligimet për mbajtjen e ligjëratave.
3. Për titullin e korepetitorit, kandidati duhet t'i plotësojë këto kushte:
 - 1.1 Të ketë të përfunduar me sukses studimet master, drejtimi i pianos ose ndonjë instrumenti tjetër;
 - 1.2 Të ketë notë mesatare jo më pak se 8 (tetë), në secilën prej këtyre studimeve.
2. Të gjitha emërimet për tituj, si dhe kohëzgjatja e punësimit janë për tre (3) vjet.

Neni 10

PËRKUFIZIME LIDHUR ME NENET 5 DERI NË 9

1. *Monografi* konsiderohet një studim i detajuar dhe tërësisht i dokumentuar dhe argumentuar, i shkruar për një subjekt studimi brenda një fushe të kufizuar kërkimi shkencor, i publikuar si botim i veçantë, në Kosovë ose vende të tjera, me ISBN dhe i kataloguar në Bibliotekën Kombëtare të Kosovës ose në të ngjashme. Monografi konsiderohet edhe një tezë e mbrojtur e doktoratës.
2. *Tekst mësimor* konsiderohet libri universitar i publikuar, për nevoja të studentëve në fushën studimore të përputhshme me fushën e autorit. Libri duhet të jetë i botuar në formë të shtypur apo elektronike, të jetë i shqyrtuar nga së paku 2 recensentë së paku me titull Dr. Sc, në fushën e njëjtë ose të afërt, të ketë ISBN të kataloguar në Bibliotekën Kombëtare të Kosovës, ose në të ngjashme.
3. Kandidati mund të jetë autor i parë ose korrespondent i *punimeve të publikuara* në revista shkencore ndërkombëtare, apo i teksteve mësimore. Autor korrespondent konsiderohet autori i punimit, i cili, shprehimisht është përcaktuar si i tillë në punim. Nëse në punimin e publikuar autori korrespondent nuk është specifikuar, autori i dytë konsiderohet si autor korrespondent.
4. Punimi duhet të botohet në revistat shkencore ndërkombëtare të indeksuara në ndonjërin prej këtyre dy databazave:
 - 1.1. **Web of Science:** <http://mjldarivate.com>, (në ndonjërin prej koleksioneve bërthamë: SCIE; SSCI; AHCI);
 - 1.2. **Scopus** (Elsevier): <https://www.scopus.com>.
5. Punimet e publikuara sipas kërkesave të kësaj rregulloreje nuk merren parasysh, nëse në fazat e vlerësimit deri në momentin e marrjes së vendimit përfundimtar konstatohet që revistat përkatëse janë të përfshira në lista të revistave ose botuesve të dyshimtë. Revista të dyshimta konsiderohen revistat, të cilat nuk e aplikojnë procesin e vërtetë të recensionit profesional (peer review), nuk kanë ISSN të vërtetë, nuk kanë uebfaqe ose kanë një të tillë të dyshimte, personi juridik apo fizik botues nuk ka adresë ose numër kontakti, deklaron adresë ose numër kontakti fiktiv, paraqet indeksim ndërkombëtar të rremë, deklaron faktor ndikimi të rremë, botuesi i tyre është i dyshimtë në kuptimin e mënyrës së menaxhimit dhe paletës së revistave që publikon. Senati rezervon të drejtën që në çdo moment ta tërheqë njohjen e publikimit në revistat e dyshimta ose botuesit e dyshimtë, por para vlerësimit përfundimtar të kandidatit.
6. Gjatë vlerësimit të kandidatit mund të pranohen edhe punimet, për të cilat ka konfirmim nga revistat përkatëse se janë të pranuar (accepted) për t'u publikuar, në rast se nuk

- ka kandidatë të tjerë që i plotësojnë kushtet tjera dhe tashmë kanë numrin përkatës të punimeve të publikuara.
7. *Aftësia për mësimdhënie* dhe ajo pedagogjike dëshmohen nëpërmjet dy (2) certifikatave për metodologji të mësimdhënies të fituara nga:
 - 6.1. Qendra përkatëse e themeluar në UKZ, ose nga qendrat e ngjashme në institucionet publike të Kosovës; ose
 - 6.2. Trajnimet nga institucione të tjera të specializuara, si trajnimet për arsimin universitar, në kuadër të projekteve ndërkombëtare, por që zgjasin jo më pak se 3 ditë; ose
 - 6.3. Të kombinuara, dhe
 - 6.4. Vlerësimi nga ZZHAC të UKZ-së.
 8. *Përvojë afatgjatë në projekte të kërkimeve themelore dhe të aplikueshme* nënkupton pjesëmarrjen së paku në një projekt, program apo grup tjetër punues (si anëtarë në hartimin apo zbatimin e dokumenteve strategjike, shkencore dhe të aplikueshme, akteve normative të lidhura me fushën e eksperiencës, redaktime shkencore në libra akademike, ekspertiza apo trajnime profesionale, recensime të teksteve shkollore të përcaktuar nga MASHT-i, recensent i monografive dhe teksteve mësimore, e të ngjashme) përmes të cilave arrihen rezultate me rëndësi për universitetin, industrinë dhe komunitetin.
 9. *Aftësia për udhëheqje akademike* nënkupton aftësitë dhe kontributin e shprehur përmes angazhimit si anëtar i komisioneve vlerësuese për zgjedhjen dhe avancimin e stafit akademik, komisioneve për mbrojtje të temave master dhe doktoratë, pjesëmarrjes në këshillin shkencor të revistave dhe të konferencave vendore apo ndërkombëtare, si dhe ushtrimin e funksioneve akademike në institucione të arsimit të lartë.
 10. *Jo më i vjetër se 30 vjet* konsiderohet periudha deri në ditën që kandidati i mbush 30 vjet dhe llogaritet deri në ditën e përmbylljes së konkursit.
 11. Të gjitha afatet në këtë rregullore nënkuptojnë ditët kalendarike, përveç, nëse specifikohet ndryshe në këtë rregullore.
 12. Për *fushën e ngushtë* të kandidatit vlerësohet dhe konstatohet fusha e ngushtë dhe e përafërt e kandidatëve në nivelin baçelor dhe master për titullin e asistentit, kurse për titullin e profesorit së paku nivelin master dhe të doktoratës. Komisioni vlerësues duhet që edhe në rastin e punimeve shkencore të konstatojë se punimet janë në fushën e kandidatit, në raport me lëndët e konkursit.
 13. Gjatë procesit të avancimit nuk lejohet tejkalimi i thirrjeve të parapara me Statutin e UKZ-së.
 14. Shtetasit e huaj dhe personat pa shtetësi në Republikën e Kosovës themelojnë marrëdhënie pune sipas Ligjit të Punës, nën kushtet dhe kriteret e përcaktuara me ligj të veçantë për punësimin e shtetasve të huaj dhe sipas konventave ndërkombëtare.

Neni 11

PROCEDURAT E KONKURSIT

1. Vendimin për shpallje të konkursit për zgjedhje apo rizgjedhje të personelit akademik e merr Senati i Universitetit, sipas propozimit të njësive akademike.
2. Vendimi për shpallje të konkursit për procedurat përzgjedhëse dhe procesin për emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në UKZ duhet të miratohet nga Senati, brenda 6 muajve para kalimit të kohës për të cilën është zgjedhur.
3. Konkursi duhet të publikohet, në uebfaqe të universitetit dhe së paku në njërën nga mjetet e shkruara të informimit.
4. Konkursi duhet të përmbajë lëndët nga programi studimor dhe numrin e mjaftueshëm të fondit të orëve që duhet të ketë një vend pune për t'u zgjedhur në thirrjen e mësimdhënësit, asistentit, lektorit apo korepetitorit.
5. Për pozitën e mësimdhënësit së paku 50 % të orëve të parapara për normë të plotë të jenë ligjërata nga lëndët obligative, kurse pjesa tjetër e orëve ligjërata nga lëndët zgjedhore ose në Fakultetin e Mjekësisë nga praktika klinike. Norma e plotë përlllogaritet brenda një viti akademik.
6. Për pozitën e asistentit së paku 50 % të orëve të parapara për normë të plotë të jenë ushtrime nga lëndët obligative, kurse pjesa tjetër e orëve ushtrime nga lëndët zgjedhore. Norma e plotë përlllogaritet brenda një viti akademik.
7. Fakultetet nuk mund të kërkojnë shpalljen e konkursit të pozitive, të cilat lidhen me personelin e rregullt, të cilit i kanë mbetur më pak se 12 muaj deri në pensionim.
8. Personeli në marrëdhënie të rregullt pune, sipas paragrafit 7 të këtij neni, nuk ka të drejtë të aplikojë në konkurs, meqë të njëjtit, me vendim të Rektorit, i vazhdohet kontrata për periudhën e mbetur deri në pension.
9. Aplikimi duhet të bëhet në formë fizike dhe elektronike.
10. Për aplikim kandidati plotëson formularin për aplikim F1 (me kompjuter), i cili gjendet në uebfaqen e UKZ-së.
11. Pjesë të kësaj rregulloreje janë edhe Formulari për Aplikim (F1) dhe Formulari për Vlerësim (F2), si dhe Raporti për zgjedhjen e personelit akademik.

Neni 12

Kandidatët që i kanë kryer studimet baçelor, master, magjistraturë dhe doktoraturë – jashtë vendit, duhet të sjellin dëshmi për nostrifikimin e diplomës përkatëse, në të kundërtën, dosja e aplikantit do të konsiderohet e pakompletuar.

Neni 13
KOMISIONI RECENSUES

1. Komisioni recensues propozohet nga Këshilli i Fakultetit në përbërje prej 3 anëtarëve.
2. Së paku dy nga anëtarët e komisionit duhet të jenë nga fusha e ngushtë e studimeve për të cilën shpallet konkursi.
 - 2.1. Anëtarët e komisionit recensues mund të jenë të brendshëm ose të jashtëm (nga universitete të tjera në vend dhe jashtë vendit);
 - 2.2. Anëtarët e komisionit recensues nuk mund të jenë me thirrje më të ulët se thirrja për të cilën konkurren dhe zgjedhet kandidati;
 - 2.3. Anëtarë të komisionit recensues mund të jenë edhe personat e pensionuar me thirrje shkencore (profesor i rregullt dhe i asociuar), por jo edhe ata të cilët e kanë kaluar moshën 70-vjeçare.
3. Nëse Komisioni recensues nuk e respekton afatin e paraparë me këtë rregullore, ose ndonjëri nga anëtarët e Komisionit tërhiqet, Këshilli i Fakultetit e ndryshon përbërjen e Komisionit dhe emëron Komision të ri brenda 10 ditëve.
4. Anëtarët e Komisionit recensues mbajnë përgjegjësi ligjore, disiplinore dhe etike për vërtetësinë dhe plotësinë e të dhënave të shënuara në Raportin recensues. Nëse rekomandimet e Komisionit apo anëtarëve të Komisionit bien qartazi në kundërshtim me Statutin e UKZ-së dhe me këtë rregullore, do të sanksionohen sipas Kodit të Etikës dhe dispozitave tjera ligjore në fuqi.

Neni 14
RAPORTI I KOMISIONIT TË VLERËSIMIT

1. Komisioni recensues shkruan, plotëson Raportin e vlerësimit¹ (F2) me propozimin konkret për përzgjedhjen, lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në UKZ.
2. Komisioni recensues mund të vendosë për intervistimin e kandidatëve dhe veçanërisht kur dy ose më tepër kandidatë kanë të arritura të ngjashme.
3. Raporti i vlerësimit i dorëzohet njësisë përkatëse akademike, për të gjithë kandidatët e paraqitur.

¹Forma e Raportit F2, është pjesë e kësaj Rregulloreje.

Neni 15

PROCEDIMI I RAPORTIT TË KOMISIONIT VLERËSUES DHE RAPORTIT TË VEÇANTË DERI TE VENDIMMARRJA PËRFUNDIMTARE

1. Raporti i vlerësues i Komisionit recensues përmban:
 - 1.1. Të dhënat për kandidatin;
 - 1.2. Të dhënat e tjera për përmbushjen e kushteve sipas kësaj rregulloreje.
2. Referati vlerësues shkruhet për të gjithë kandidatët, që kanë plotësuar kushtet e konkursit, me arsyetime të detajuara.
3. Gjatë procesit të vlerësimit kandidatët vlerësohen nga ZZHAC dhe në bazë të një ligjërate provuese.
 - 3.1. Ligjëratat provuese paraqitet vetëm me rastin e pranimit për herë të parë në punë në UKZ. Në cilësinë e vëzhguesit, përveç anëtarëve të Komisionit recensues, mund të asistojë së paku edhe një anëtar nga stafi menaxhues i fakultetit apo universitetit në ligjëratën provuese;
 - 3.2. Për kandidatët që kanë themeluar marrëdhënie pune më herët, vlerësimi bëhet në bazë të vlerësimit të performancës në mësimdhënie nga ZZHAC të UKZ-së.
4. Në fund të referatit qëndron propozimi për zgjedhje të kandidatit më të mirë ose për moszgjedhje të asnjë kandidati.
5. Në propozimin për zgjedhje elaborohen arsyet e propozimit, si dhe konstatimet për secilin kandidat që nuk është propozuar për zgjedhje.
6. Komisioni recensues ia dorëzon Raportin njësisë akademike, pas miratimit të vendimit për formimin e komisioneve recensuese.
7. Nëse ndonjëri nga anëtarët e Komisionit recensues ka mendim të ndryshëm për propozimin për zgjedhjen e kandidatit, ai mund të paraqesë një "Raport vlerësues të veçantë". Ky Raport vlerësues duhet të jetë i plotë dhe në përputhje me kërkesat e detajuara.
8. Në raste të tilla, dekani do të procedojë me "Referatin vlerësues të veçantë", sikurse me referatin e parë vlerësues, por, duke e radhitur gjithmonë pas referatit të parë.
9. Këshilli i Fakultetit dhe Senati i Universitetit mbajnë të drejtën të pranojnë njërin, të refuzojnë të dy raportet, por nuk mund të miratojnë të dy raportet për të njëjtën pozitë.
10. Universiteti, nëpërmjet Zyrës së burimeve njerëzore e publikon referatin vlerësues të komisionit recensues.
11. Kandidatët kanë të drejtën e ankesës në referatin vlerësues:
 - 11.1. Ankesën ia drejtojnë Këshillit të Fakultetit;
 - 11.2. Këshilli i Fakultetit formon komision prej tre anëtarësh për zgjidhjen e ankesave ndaj raporteve të komisioneve vlerësuese në instancë të parë;

- 11.3. Komisioni mund të miratojë, të refuzojë apo të hedhë ankesën.
12. Këshilli i Fakultetit voton raportin e Komisionit recensues, bashkë me Raportin e komisionit të ankesave ndaj pretendimeve të kandidatëve.
 13. Propozimin e votuar, Këshilli i Fakultetit e dërgon në Komisionin e Studimeve të Universitetit.
 14. Komisioni i Studimeve e këshillon Senatit për vendimmarrje me anë të Raportit të Komisionit të Studimeve.
 15. Senati, me shumicë votash, voton për apo kundër Referatit vlerësues për kandidatët veç e veç. Referati vlerësues duhet të shoqërohet me raportin e Komisionit të Studimeve.
 16. Nëse propozimi refuzohet, ai i kthehet për rishqyrtim Këshillit të njësisë akademike.
 17. Nëse Këshilli i njësisë akademike edhe pas rishqyrtimit sjellë të njëjtin propozim, Senati merr vendim përfundimtar.
 18. Me vendimin e Senatit njoftohen të gjithë kandidatët që kanë plotësuar kushtet e konkursit.
 19. Komisioni i ankesave dhe i parashtresave të Senatit përpilon një raport me shkrim, lidhur me ankesat e kandidatëve.
 20. Në rast se Komisioni i ankesave miraton apo refuzon pretendimet e kandidatëve, çështja mbyllet me vendim nga Senati.
 21. Vendimi i Senatit është përfundimtar.

Neni 16

Gjithë personeli akademik, pas përfundimit të procedurave të rregullta, do të emërohet nga Rektori, sipas vendimit të Senatit, të bazuar në propozimin e Këshillit të Fakultetit.

Neni 17

AFATET E KONKURSIT

1. Konkursi zgjat 15 ditë nga dita e publikimit.
2. Formimi i Komisionit recensues bëhet brenda 10 ditëve nga shpallja e konkursit.
3. Përgatitja e raporteve vlerësuese nga Komisioni recensues dhe propozimi apo refuzimi për zgjedhjen e kandidatëve bëhet në afat prej 30 ditëve pas miratimit të Komisionit recensues nga Senati.
4. Publikimi i raporteve të komisioneve recensuese bëhet 3 ditë pas miratimit nga këshillat e fakulteteve.
5. Publikimi i recensioneve të kandidatëve dhe ankesat ndaj propozimit të Komisionit recensues bëhen në afat prej 15 ditësh.

6. Shqyrtimi i ankesave ndaj raporteve të Komisionit recensues dhe miratimi i raporteve dhe ankesave në Këshillin e fakultetit bëhet brenda 15 ditëve.
7. Këshillat e fakulteteve i dërgojnë raportet e komisioneve recensuese dhe vendimet lidhur me ankesat e kandidatëve në Komisionin e Studimeve brenda 10 ditëve.
8. Komisioni i Studimeve, brenda 20 ditëve, duhet t'ia dorëzojë Senatit të Universitetit propozimet e komisioneve recensuese dhe raportin e Komisionit të Studimeve.
9. Senati merr vendim, lidhur me propozimet e këshillave të fakulteteve më së largu 20 ditës, pas pranimit të raportit të Komisionit të Studimeve.
10. Nëse Senati refuzon propozimin e Këshillit të fakultetit, lënda përkatëse, brenda 3 ditëve, kthehet për rishqyrtim në Këshillin e fakultetit.
11. Këshilli i fakultetit obligohet që brenda 7 ditëve, pas pranimit të vendimit të Senatit për refuzim, të rishqyrtojë lëndët për rivlerësim dhe vendimin përkatës t'ia dorëzojë brenda 3 ditëve Komisionit të Studimeve.
12. Nëse këshilli i fakultetit sjell të njëjtin propozim Senati në një afat jo më të gjatë se 15 ditë, nga pranimi i tyre, merr vendim përfundimtar.
13. Ndaj vendimit të Senatit, në afat jo më larg se 15 ditë, pas publikimit në uebfaqe të universitetit dhe dërgimit në formë elektronike të vendimit palës, mund të bëhet ankesë në Komisionin për ankesa dhe parashtresa të Senatit, që shërben si instancë e fundit e ankimit në UKZ.
14. Në Komisionin e ankesave nuk mund të jenë anëtarët e Senatit dhe anëtarët e Komisionit vlerësues.
15. Secili anëtar i stafit akademik i rizgjedhur, ka të drejtë të kërkojë avancim një herë brenda periudhës 4-vjeçare.
16. Për raste të veçanta, para arritjes së propozimit në Senat, me kërkesë të Rektorit, afati i gjithë procedurës mund të zgjatet më së shumti deri në 30 ditë.

III. DISPOZITAT KALIMTARE

Neni 18

1. Nga data e miratimit të kësaj rregulloreje, merren në konsideratë vetëm punimet në përputhje me këtë rregullore.
2. Deri me datë 30 shtator 2023 do të merren parasysh edhe punimet sipas Rregullores Nr. 01/1336 e datës 18.06.2021, të publikuara deri në ditën e miratimit të kësaj rregulloreje-datë 28.04.2022.
3. Zyra e Rektorit brenda afatit prej 30 ditëve nga miratimi i kësaj rregulloreje përpilon formën e Raportit recensues (F2), i cili u shërben për punë komisioneve vlerësuese. Raporti përmban të gjitha pjesët/elementet që kërkohen të evidentohen lidhur me zgjedhjen, rizgjedhjen dhe avancimin e stafit akademik.

IV. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 19

1. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregullore pushon së zbatuari Rregulloja për zgjedhjen/rizgjedhjen e personelit akademik në Universitetin “Kadri Zeka”, Nr.01/1336, datë 18.06.2021.
2. Kjo Rregullore hyn në fuqi nga dita e miratimit në Senatin e Universitetit “Kadri Zeka” Gjilan.
3. Senati i Universitetit në mbledhjen XXXIII, mbajtur më 28.04.2022, njëzëri e miratoi këtë rregullore.

Gjilan, më 28.04.2022

